



Në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare Nr.13/29 qershor 2023), si dhe në përputhje me nenin 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (Gazeta Zyrtare Nr.1/05 Janar 2023) duke u bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për kompensimin për funksionin shtesë, Agjencia e Kosovës për Akreditim shpall:

KONKURS

Për anëtarë të Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim

- 1. Dy (2) anëtarë profesorë universitarë**
- 2. Kohëzgjatja e angazhimit:** Anëtari/ja zgjidhet për një mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër

Kualifikimi dhe përshtatshmëria profesionale

Një kandidat për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim duhet të dëshmojnë njohuri të sistemit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe njohuri për sigurimin e cilësisë.

Kandidati NUK kualifikohet si anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës, nëse:

- a.** Aktualisht është zyrtar ose menaxher në një institucion të arsimit të lartë publik apo privat në Kosovë;
- b.** Aktualisht është nëpunës i shërbimit civil;
- c.** Aktualisht është i angazhuar në ndonjë subjekt politik në Kosovë, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- d.** Ka çfarëdo konflikti të interesit që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat si anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim

Kompensimi

Kompensimi i anëtareve të Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim bëhet në bazë të nenin 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (Gazeta Zyrtare Nr.1/05 Janar 2023) si dhe në Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për kompensimin për funksionin shtesë.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në;
- Dokumentin Identifikimi (kopje të dokumentit identifikues, pasaportës, letërnjoftimit apo certifikatës së shtetësisë, e cila duhet të jetë valide).
- Certifikatën mbi gjendjen penale të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën *e-Kosova* do të pranohen);
- Diplomën e Doktoratës-Diploma e fituar jashtë vendit duhet te jete e nostrifikuar.
- Vërtetimin e përvojës së punës të lëshuar nga institucioni kompetent përgjegjës - zyra e personelit ku specifikohet data e fillimit dhe data e mbarimit të marrëdhënies së punës.
- Pasqyrat e kontributeve pensionale - Trusti Pensional, ky kriter nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Dëshmitë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI ose të këtë dëshmi që është në proces të nostrifikimit);

Vlerësimi i CV-së së kandidatëve aplikues

Kandidatët / aplikantët do të vlerësohen nga një Komision i themeluar sipas paragrafit 4 dhe 5 te nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare Nr.13/29 qershor 2023)

Mënyra e aplikimit

Aplikimi bëhet duke i dërguar dokumentet në E-Mail: kaltrina.n.hyseni@rks-gov.net, me përshkrimin në Subjekt: **Aplikim për anëtar të Komisionit të Ankesave.**

Të gjithë kandidatët e interesuar mund të aplikojnë **nga data 11-26 shtator 2024,**

Agjencia e Kosovës për Akreditim inkurajon të gjithë të interesuarit dhe mirëpret aplikimet e secilit kandidatë për tu bërë pjesë e Komisionit të Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.